



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:205661

Datë: 15.11.2023

Numri i dokumentit: 04921123

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.841/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Leon Përlaska, në çështjen penale kundër të pandehurave M. P. dhe F. M. nga Peja, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1923/22 të datës 06.10.2022 dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, jashtë seancës, me datë 15.11.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1923/22 të datës 06.10.2022, andaj gjykata konform dispozitës së nenit 495 të KPPRK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

Të pandehurat:

I. M. P., e lindur me datën.....në Pejë, me vendbanim në rr. "M. P." pa nr., nga i ati B. dhe e ëma Fi., e gjinisë Z., e martuar, e identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., e nacionalitetit Shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës, dhe

II. F. M., e lindur me datën ..... në Pejë, me vendbanim në rr. "M. P." pa nr., nga i ati B. dhe e ëma F., e gjinisë Z., e pa martuar, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ....., e nacionalitetit Shqiptar, shtetase e Republikës së Kosovës.

SHPALLEN FAJTORE

SEPSE:

I. E pandehura M. P.:

Me datë 01.09.2022, rreth orës 17:00, në rrugën “Mbreti Pirro” në Pejë, me qëllim të frikësimit seriozisht kanos personin tjetër me fjalët se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe, dhe atë të dëmtuarën Sh. N., ashtu që pasi e dëmtuara si qiradhënëse shkon në banesën e të pandehurës dhe kërkon leje nga babai i saj B. që të vendosë në atë banesë dy divane sepse të i njëjti ishte i njoftuar më parë se duhej liruar banesën sipas marrëveshjes, në ato momente ndërhyjnë e pandehura duke iu drejtuar të dëmtuarës me fjalët “*Ti je kurvë, rrugejk, edhe me të dal qaty vi t’shkyj*”, ku tek e dëmtuara shkakton frikë,

- Me çka ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181, par. 1, i KPRK-së.

II. E pandehura F. M.:

1.Me datë 01.09.2022, rreth orës 17:00, në rrugën “M. P.” në Pejë, me qëllim të frikësimit seriozisht kanos personin tjetër me vepra se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe, dhe atë të dëmtuarën Sh. N., në mënyrën që, pas ngjarjes së ndodhur sipas pikës së parë të akuzës, ku edhe krijohet konflikt verbal në mes të pandehurës M. dhe të dëmtuarës Sh., ku e pandehura F. nisët në drejtim të të dëmtuarës Sh. me qëllim që ta sulmojë fizikisht mirëpo ndalohet nga nëna e saj”, ku tek e dëmtuara shkakton frikë,

- Me çka ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181, par. 1, i KPRK-së.

2.Me datë 01.09.2022, rreth orës 17:05 minuta, në rrugën “Mbreti Pirro” në Pejë, me qëllim të frikësimit seriozisht kanos personin tjetër me vepra se do t’i shkaktojë ndonjë të keqe, dhe atë të dëmtuarën D. N., në mënyrën që, pas ngjarjes së ndodhur sipas pikës së parë të akuzës, ku edhe krijohet konflikt verbal në mes të pandehurës M. dhe të dëmtuarës Sh., kur e dëmtuara e thërret nënën e saj Sh. N. që ka kush merret me këtë punë dhe të shkon dhe ta lajmërojë policinë, aty ndërhyjnë e pandehura F. e cila i drejtohet të dëmtuarës D. me fjalët “mos u përziej ti se po të qky edhe ty”, me ç’rast tek e njëjta shkakton frikë,

- Me çka ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181, par. 1, i KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 38, 39, 40, 43, dhe 69 të KPRK-së, si dhe bazuar në nenet 365, 493, 495 të KPPK-së, të pandehurave u shqipton secilës veç e veç:

### DËNIM ME GJOBË

- I. Në lartësi prej nga 100 € (njëqind) Euro, të cilin dënim janë të obliguara që ta paguajnë në afat prej 3 muajsh, prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi.
- II. Në rast që të pandehurat nuk dëshirojnë apo nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, gjykata mund ta zëvendësoj dënimin me gjobë më dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me njëzet (20) euro gjobë.
- III. OBLIGOHEN të pandehurat që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga 20 € (njëzet) euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej nga 20 € (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

### ARSYETIM

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1923/22 të datës 06.10.2022, kundër të pandehurave M. P.dhe F. M. nga Peja, për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së. Së bashku me aktakuzën prokuroria ka dorëzuar kërkesën me të cilën ka kërkuar që të pandehurave t’i shqiptohet urdhri ndëshkimor-dënim me gjobë.

Të pandehurat janë akuzuar për veprën penale Kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, që e ka këtë përshkrim: “Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkakimit të ankthit te personi i tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj”.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjykata erdhi ne përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 par.1 dhe 495 par.1 dhe 2 të KPPK-së, ashtu që vendosi ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Raporti i oficerit B. B.#... dt. 01.09.2022; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarën Sh. N. dt. 01.09.2022; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dëmtuarën-dëshmitaren D. N.j dt. 01.09.2022;Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin B. M, dt. 01.09.2022; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarën F. M. dt. 01.09.2022; Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarën M. P.dt. 01.09.2022; si dhe të shikohen shkresat e tjera të lëndës, janë prova që ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrit ndëshkimor dhe se të pandehurat kanë kryer veprën penale Kanosje nga neni 181 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074).

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, gjykata u mbështet në nenin 43 par.1 dhe 2, 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (06/L-074), ku nga provat e bashkangjitura lëndës dhe faktet e përshkruara si në aktakuzë gjykata erdhi në përfundim se dënimi me gjobë i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrij qëllimin e dënimit siç parashihet në nenin 38 të KPPRK-së dhe se ky dënim do të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale të ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor është marrë, në kuptim nenit 449 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga se u tha më lartë, në kuptim të neneve 364 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal  
P.nr.841/2022, me datë 15.11.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Leon Përlaska

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimet të tij, në këtë gjykatë.

**Vërejtje:**

Nëse nuk paraqitet kundërshtimi brenda afatit të lartshënuar, urdhri ndëshkimor merr formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar të pandehurit ekzekutohet.